



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 544 Akti

Nr. 586 Vendimi
Tiranë, më 14.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 14.11.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Edlira Bako**, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Edlira Bako (Duraj) dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Edlira Bako, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e prokurores së komanduar pranë Ministrisë së Drejtësisë, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Znj. Edlira Bako, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 22.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Komisioni, pas shortimit të kësaj çështjeje, verifikoi së pari statusin e subjektit të rivlerësimit.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë¹, me anë të vendimit nr. ***, datë 11.10.2019, ka vendosur të caktojë subjektin Edlira Bako në detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

¹Mbështetur në parashikimet e nenit 184 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në zbatim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për çështjet e mëposhtme në lidhje me të gjithë prokurorët: (a) emërimin; (b) caktimin në pozicion;

7. Me qëllim vlerësimin e statusit juridik, Komisioni, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 24.3.2022, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kërkoi dosjen e plotë dhe relacionin përkatës për caktimin e znj. Edlira Bako në detyrën e prokurorit.

8. Komisioni, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, lidhur me karrierën profesionale dhe më tej caktimin e subjektit në detyrën e prokurorit, evidentoi se:

9. Subjekti i rivlerësimit Edlira Bako, me vendimin nr. ***, datë 13.2.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar zëvendësprokurore në Prokurorinë e Rrethit Tepelenë dhe e ka ushtruar këtë detyrë për një periudhë 7-vjeçare deri në vitin 2003.

10. Në datën 4.2.2003, me urdhrin nr. *** të ministrit të Drejtësisë, ajo është emëruar inspektore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë dhe në vitin 2014 është emëruar drejtoreshë e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë. Më tej, me anë të urdhrit nr. ***, datë 23.3.2016, është caktuar drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë.

11. Referuar në ligjin e kohës nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas nenit 44, prokurori mund të punojë në nivele drejtuese dhe ekzekutuese të kabinetit të ministrit dhe në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e punësimit njihet si periudhë vjetërsie në punë si prokuror për efekt të kërkesave profesionale. Prokurorët që punojnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë me kërkesën e tyre rëmërohen pa konkurs prokurorë. Ky ligj nuk përcaktonte kufizim kohor për periudhën e shërbimit të prokurorëve në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë.

12. Më tej, me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, në dispozitën e titulluar “Ruajtja e statusit të prokurorit” u përcaktua se prokurorët mund të shërbejnë në strukturat juridiko-profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës për një afat deri në katër vjet. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si prokuror, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. Ky ndryshim ligjor që hyri në fuqi në janar të vitit 2009, përcaktoi një kufizim kohor për periudhën e shërbimit në këto struktura për të gjithë prokurorët e komanduar, të cilët donin të vazhdonin të ruanin statusin².

(c) transferimin; (ç) ngritjen në detyrë; (d) komandimin dhe rëmërimin; (dh) vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale; (e) vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin; (ë) çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

²Sipas nenit 57 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli, pasi merr mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati, mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuar. Vetëm në ato raste kur magjistrati ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, Këshilli konsideron me përparësi në lëvizjen paralele ose procedurat e ngritjes në detyrë. Magjistrati ka të drejtë që pas periudhës së komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj.

13. Në vijim të hetimit³ rezultoi se në janar 2013, qershor 2014, nëntor 2016 dhe mars 2018 subjekti ka kërkuar rikthimin në detyrën e prokurores, sipas vendeve vakante të shpallura nga Prokuroria e Përgjithshme në vitet përkatëse. Gjithashtu, me kërkesën nr. *** prot., datë 26.2.2019, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, subjekti përsëri për herë të pestë ka kërkuar përfundimin e periudhës së punësimit/komandimit në Ministrinë e Drejtësisë dhe rikthimin në detyrën e prokurores.

14. Këshilli i Lartë i Prokurorisë⁴, me anë të vendimit nr. ***, datë 11.10.2019, ka vendosur të caktojë subjektin Edlira Bako në detyrën e prokurores pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çka tregon se subjekti e ka ruajtur statusin e magjistratit.

15. Komisioni, pasi kërkoj dosjen e plotë që lidhet me caktimin e subjektit Edlira Bako në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe analizoi dokumentacionin, vlerëson se znj. Edlira Bako gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit referuar parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, duke vijuar hetimin administrativ.

16. Në datën 8.7.2020, përmes postës elektronike⁵, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoj të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoj subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

17. Trupi gjykues, me vendimin datë 3.11.2022, vendosi: (i) të përfundoj hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Edlira Bako, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe po në të njëjtën datë 3.11.2022, përmes postës elektronike⁶, i njoftoi subjektit të rivlerësimit vendimin mbi përfundimin e hetimit paraprak.

18. Në datën 10.11.2022 subjekti paraqiti me anë të postës elektronike⁷ dhe pranë Komisionit pretendimet e saj me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

³Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2022, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

⁴Mbështetur në parashikimet e nenit 184 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në zbatim të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për çështjet e mëposhtme në lidhje me të gjithë prokurorët: (a) emërimin; (b) caktimin në pozicion; (c) transferimin; (ç) ngritjen në detyrë; (d) komandimin dhe riemërimin; (dh) vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale; (e) vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin; (ë) çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

⁵E-mail datë 8.7.2020, ora 10:03 "Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë".

⁶E-mail datë 3.11.2022, ora 12:05 "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

⁷E-mail datë 10.11.2022, ora 07:40 "Parashtrime".

19. Më tej, subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike⁸ se trupi gjykues me vendimin e datës 11.11.2022 vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 14.11.2022, në orën 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

20. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Edlira Bako, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

21. Në datën 14.11.2022 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht në seancë.

22. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

23. Znj. Edlira Bako, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

24. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Edlira Bako, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

25. Seanca dëgjimore e datës 14.11.2022 u ndërpre, për të rifilluar po në datën 14.11.2022, ora 11:30 për shpalljen e vendimit.

26. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 14.11.2022, subjekti i rivlerësimit Edlira Bako kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

27. Subjekti i rivlerësimit Edlira Bako ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

28. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁸E-mail datë 11.11.2022, ora 11:47 “Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit”.

29. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

30. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

31. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Edlira Bako, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe ka plotësuar deklaratën e largimit nga detyra në vitin 2004, me tej ka rifilluar të deklarojë në vitin 2014, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

32. Subjekti i rivlerësimit në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

33. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë: A. B., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe J. B., vajza e subjektit.

34. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në

analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitin 2003 dhe deklaratën e largimit nga detyra në vitin 2004, si dhe deklaratat e viteve 2014 – 2016; (ç) provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

35. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament me sip. 59.8 m², vlera 9.264 lekë, në M.

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament banimi me sip. 59.8 m², Lagjja Nr. ***, në M., çmimi 9.264 lekë. Nuk është bërë ende rivlerësimi. Pjesa takuese: 1/5. Si burim krijimi deklaroi: përfituar nga babai Y. D., nga privatizimi i banesave në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.2.1992. Për vërtetimin e deklaratimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁹.

1.2. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se – në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti nuk ka deklaruar pronësinë/pjesën takuese mbi këtë pasuri. Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2014 ka deklaruar apartament banimi me sip. 59.8 m², z. k. ***, regjistruar me nr. ***, datë 26.5.1994, në ZVRPP-në Tepelenë. Pasuri e përfituar nga privatizimi i banesave me kontratën nr. ***, datë 26.5.1994.

1.3. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga ZVRPP-ja Tepelenë në datën 18.1.2017 për pasurinë apartament me sip. 59.8 m², regjistruar në emër të znj. Edlira Duraj (Bako) me nr. ***, shk. ***, kati ***, Lagjja Nr. ***, M. Subjekti zotëron 1/5 pjesë takuese, në bashkëpronësi me shtetasit Y., M., A. dhe F. D.. Kjo pronë

⁹Vërtetim datë 18.1.2017, lëshuar nga ZVRPP-ja Tepelenë për pasurinë nr. ***, e ndodhur në M., lloji “apartament” me sip. 59.8 m², kontrata për privatizimin e banesës datë 26.5.1994, kontrata e shitjes së banesës datë 26.5.1994 nga NK. Banesa M., vërtetim hipotekor datë 21.3.2014.

është përfituar nga privatizimi i banesave sipas kontratës datë 26.5.1994 dhe nuk është bërë ende rivlerësimi.

1.4. Sipas kontratës për privatizimin e banesës datë 26.5.1994, të lidhur me N.K. Banesa M. është përfituar apartamenti me sip. 59.8 m², në vlerën 9.264 lekë, nga shtetasit Y., M., A., F. dhe Edlira Duraj, me vërtetimin noterial nr. ***, datë 26.5.1994. Referuar vërtetimit hipotekor të lëshuar në datën 21.3.2014, rezulton se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 26.5.1994, apartamenti me sip. 59.8 m², në M., është i regjistruar në pronësi të shtetasve Y., M., A., F. dhe Edlira Duraj. Pjesa takuese: 1/5 secili.

1.5. Referuar informacionit të përcjellë nga ASHK Drejtoria Vendore Tepelenë¹⁰, konfirmohet pasuria e paluajtshme apartament me sip. 59.8 m², regjistruar në emër të subjektit dhe familjarëve, përfituar me anë të kontratës së privatizimit datë 26.5.1994, në vlerën 9.264 lekë.

1.6. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.7. Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri, pasi nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2003 - 2004 pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme apartament me sip. 59.8 m² dhe të drejtat reale mbi të, bazuar në parashikimet e germës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit subjekti mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to.

1.8. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë faktin se burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm nga privatizimi, është regjistruar në regjistrat publikë dhe kjo pasaktësi në deklaram nuk lidhet me fshehjen e kësaj pasurie duke e vendosur në emër të personave të tjerë, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore sipas ligjit nr. 84/2016.

1.9. Në konkluzion, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi në deklaram nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjë shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2. Gjendja e llogarisë së pagës në vlerën 692 lekë

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje të llogarisë së pagës datë 23.1.2016, në shumën 692,29 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve të saj, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹¹.

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 31.8.2020.

¹¹Konfirmim nr. *** prot., datë 23.1.2017, lëshuar nga “Credins Bank”.

2.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se – në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017, lëshuar nga “Credins Bank”, ku konfirmohet gjendja e llogarisë në emër të subjektit në shumën 692,29 lekë, nga e cila 77.307 lekë janë detyrim *overdrafti*. Referuar informacionit të përcjellë nga “Credins Bank”¹² konfirmohet llogari page në lekë në emër të subjektit. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë vërehet se kreditimet vijnë nga pagat dhe honorarët.

2.3. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

3. Gjendja cash në shumën 200.000 lekë

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash*, tepruar nga kredia e marrë në shumën 200.000 lekë, në bankën “****” sh.a.

3.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se – në DIPP/2016 subjekti ka deklaruar *shtesë gjendjeje cash, tepruar nga kredia e marrë në bankën “****” sh.a. në shumën 200.000 lekë*. Referuar informacionit të përcjellë nga “OTP Bank”¹³ konstatohet se në datën 7.11.2016, në llogarinë e subjektit është lëvruar kredia me vlerë 800.000 lekë¹⁴, nga e cila subjekti ka tërhequr një shumë totale prej 601.500 lekësh, midis të cilave edhe një tërheqje me vlerë 200.000 lekë më 27.11.2016.

3.3. Sa më lart, për sa i përket gjendjes *cash* prej 200.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *Vetting*, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

3.4. Më tej, Komisioni analizoi deklaratimet ndër vite të subjektit lidhur me likuiditetet *cash*, konkretisht: (i) në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës së vitit 2014, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 500.000 lekë, me burim nga kursimet familjare; (ii) në DIPP/2016, ka deklaruar: “*Pakësim 500.000 lekë, kursimet e deklaruara në deklaratën e pasurisë në vitet 2014 janë shpenzuar për pushimet familjare etj. Gjatë tri viteve 2014, 2015 dhe 2016, saktësim të cilin kam harruar ta bëj në deklaratimet e tjera, nisur edhe nga fakti se veç e veç kanë qenë shpenzime vjetore më pak se kufiri i përcaktuar si detyrim për t’u deklaruar*”.

3.5. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2005 – 2016, të fragmentizuar në disa pjesë, konkretisht: (i) për periudhën 1.1.2005 – 25.2.2014, gjatë së cilës janë krijuar likuiditetet me vlerë 500.000 lekë, referuar deklaratimit në deklaratën e pasurisë përpara lindjes së detyrimit për deklarim në vitin 2014; (ii) për periudhën 26.2.2014 - 31.12.2014, momenti i lindjes së detyrimit për deklarim deri në fund të vitit kalendarik; (iii) për vitin 2015, (iv) për vitin 2016.

3.6. Lidhur me deklaratimin e subjektit se likuiditetet *cash* prej 500.000 lekësh janë pakësuar ndër vite, Komisioni, për efekt të analizës financiare, nuk e pasqyroi këtë pakësim në vitet

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2020.

¹³Shkresa e protokolluar në Komision nr. *** prot., datë 28.7.2020.

¹⁴Kredi me këste - standard nr. ***, në vlerën 800.000 lekë, hapur në datën 7.11.2016 dhe maturimi më 7.11.2019.

2014 dhe 2015, pasi: (i) nuk është deklaruar në DIPP-të e viteve përkatëse; (ii) nuk është e mundur të përcaktohet vlera specifike për secilin vit kalendarik.

3.7. Për rrjedhojë, në analizën financiare u pasqyruan këto gjendje të likuiditeteve *cash*: në datën 31.12.2014, vlera 500.000 lekë; në datën 31.12.2015, vlera 500.000 lekë; dhe në datën 31.12.2016, vlera 200.000 lekë (sipas deklaramit në DIPP/2016).

3.8. Në analizën financiare u konsideruan: (i) blerja e automjetit tip “Ford”¹⁵; (ii) ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve *cash*¹⁶ dhe atyre në bankë; (iii) kreditë e marra pranë bankës ***/OTP¹⁷; (iv) të ardhurat e subjektit nga paga dhe honorarë pranë KP-së, KLD-së, KZABGJ-së, ISSH-së; (v) të ardhurat e bashkëshortit nga paga dhe aktiviteti privat¹⁸; (vi) të ardhura nga interesa bankare dhe stimul për rezultatet në shkollë të vajzës¹⁹; (vii) shpenzimet jetike²⁰; (viii) shpenzime shumat e marrë kredi dhe pagesat për shlyerjen e kredive²¹; (ix) shpenzimet për udhëtimet jashtë nga sistemi *TIMS*²².

3.9. Në përfundim të kësaj analize rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar likuiditetet *cash* në vlerën 500.000 lekë deri në datën 25.2.2014, për sa kohë që për periudhën 1.1.2005 – 25.2.2014 rezultoi një balancë pozitive. Po kështu, rezultoi me balancë pozitive analiza financiare e kryer për periudhën 26.2.2014 - 31.12.2014 dhe ajo e kryer për vitin 2016, ndërsa për vitin 2015 rezultoi një balancë negative në vlerën 231.518 lekë.

3.10. *Lidhur me aspektin deklarativ* – rezultoi se subjekti ka kryer deklaram të paplotë në DIPP-të e viteve 2014 - 2015, pasi nuk ka deklaruar pakësimin e likuiditeteve *cash* prej 500.000 lekësh të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2014.

3.11. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 231.518 lekë për të kryer shpenzimet në vitin 2015.*

3.12. Subjekti në përgjigje të prapësimeve theksoi se në deklaratën e vitit 2016 ka deklaruar pakësimin e vlerës 500.000 lekë, duke shpjeguar se është shpenzuar në tri vitet 2014, 2015 dhe 2016. Ndonëse nuk e ka pasqyruar rregullisht dhe saktësisht për secilin vit këtë pakësim, në DIPP/2016 ka deklaruar se kursimet prej 500.000 lekësh nuk i ka më, pasi i ka shpenzuar në këto tri vite. Në vijim, subjekti deklaroi se burim i çdo shpenzimi dhe kursimi familjar kanë qenë pikërisht ato që janë identifikuar dhe pasqyruar edhe nga hetimi i Komisionit dhe se nuk ka asnjë pasuri të paluajtshme të blerë gjatë viteve 1996 e aktualisht.

¹⁵Trajtuar në pikën 5 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁶Analizuar më lart.

¹⁷Trajtuar në pikën 7 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁸Trajtuar në pikën 8 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁹Evidentuar në lëvizjet e llogarive bankare.

²⁰Shkresë nr. ***, datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së.

²¹Trajtuar në pikën 7 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

²²Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019.

Shpenzimet e jetesës kanë qenë të kufizuara dhe gjithmonë në varësi të këtyre të ardhurave dhe mund të kenë qenë edhe më të ulëta se ato të përcaktuara. Subjekti deklaroi se pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni ka si shkak vetëm pasaktësitë në deklaratimet vjetore, si dhe, sikundër është konstatuar nga hetimi, nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë së kredisë në vlerën 500.000 lekë është konstatuar se janë tërhequr *cash* shumat 400.000 lekë në datën 8.6.2015 dhe 150.000 lekë në datën 31.8.2015. Kjo vlerë e tërhequr *cash* duket se nuk është evidentuar në analizën financiare të vitit 2015 si hyrje *cash*, por është pasqyruar vetëm si shpenzim vlera 415.000 lekë dhe si detyrim vlera 500.000 lekë.

Në përfundim, subjekti deklaroi se: *“Duke qenë se nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni është provuar se kam pasur burime ligjshme të mjaftueshme për të krijuar likuiditetin cash në vlerën 500.000 lekë, duke qenë se viti paraardhës dhe gjithë vitet e tjera janë me bilanc pozitiv, duke qenë se e kam deklaruar pakësimin e kësaj vlere në vitet 2014, 2015 dhe 2016, pavarësisht se kam harruar të vendos vlerën specifike për secilin vit, vlerësoj se nëse nga Komisioni konsiderohet kjo rrethanë, në analizën financiare nuk do të rezultojë më mungesë burimesh të ligjshme për shpenzimet e vitit 2015 (ku përfshihet edhe pagesa e garancisë sipas kontratës së qirasë datë 6.2.2015)”*.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

3.13. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

3.14. Deklarimet nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar në vitet 2014 dhe 2015 janë të pasakta, pasi nuk ka deklaruar pakësimin e tyre sipas kërkesave ligjore. Në DIPP/2016, në përgjigje të pyetësorëve gjatë hetimit, si dhe në prapësime, subjekti pretendon se kjo shumë është shpenzuar përgjatë tri viteve 2014, 2015 dhe 2016, saktësim të cilin ka harruar ta bëjë në deklaratimet e interesave privatë në vitet përkatëse. Ndërkohë që, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për “[...] ndryshimet (shtesa dhe pakësime nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaratimit” që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]”²³.

3.15. Komisioni, gjithashtu, thekson se Kolegji në jurisprudencën e tij e ka trajtuar gjerësisht çështjen e deklaratimit të likuiditetit *cash* në deklaratat e interesave privatë, të cilat përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi

²³Faqja 3 e formularit të deklaratimit, që i përket pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave private dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme.

të ekzistencës së kësaj pasurie, ndërkohë që pretendimet e subjektit lidhur me pakësimin e likuiditeteve *cash* mbetën në nivel deklarativ.

3.16. Për rrjedhojë, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 231.518 lekë për kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2015.

3.17. Në konkluzion, Komisioni vlerëson se mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, balanca negative në vlerën 231.518 lekë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

PASURITË E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT

4. Apartament me sip. 79.3 m², në vlerën 9.264 lekë, në Tepelenë

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se ka në bashkëpronësi apartament banimi me sip. 79.3 m², lagjja “****”, Tepelenë. Çmimi i privatizimit: 23.125 lekë. Nuk është bërë ende rivlerësimi. Pjesa takuese: 1/4. Si burim krijimi deklaroi *përfitur nga babai E. B. nga privatizimi i banesave në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.2.1992*. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁴.

4.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se – në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar pronësinë/pjesën takuese mbi këtë pasuri. Në DIPP/2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi me sip. 79.3, z. k. ****, regjistruar me nr. ****, datë 25.10.1993, në ZVRPP-në Tepelenë. Pasuri e përfitur nga privatizimi i banesave me kontratë nr. ****, datë 25.10.1993. Pjesa takuese: 1/4.

4.3. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga ZVRPP-ja Tepelenë në datën 18.1.2017 për pasurinë e regjistruar në emër të shtetasit A. B. nr. ****, z. k. ****, Tepelenë, lloji “apartament” me sip. 79.3 m² dhe pjesë takuese 1/4. Sipas kontratës për privatizimin e banesës datë 25.10.1993, apartamenti është përfitur në vlerën 23.125 lekë.

4.4. Referuar informacionit të përcjellë nga ASHK Drejtoria Vendore Tepelenë²⁵ konfirmohet se pasuria e paluajtshme apartament me sip. 79.3 m², e regjistruar në emër të shtetasve E., N., A. B. dhe P. T., përfitur me anë të kontratës së privatizimit datë 25.10.1993, në vlerën 23.125 lekë.

²⁴Vërtetimi datë 18.1.2017, lëshuar nga ZVRPP-ja Tepelenë për pasurinë lloji “apartament” me sip. 79.3 m², e regjistruar në emër të shtetasit A. B., kontrata për privatizimin e banesës datë 24.9.1993 dhe kontrata e shitjes së banesës datë 25.10.1993 nga N. K. Banesa Tepelenë, vërtetim hipoteke datë 21.3.2014.

²⁵Shkresë nr. **** prot., datë 31.8.2020.

4.5. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

4.6. Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2003 – 2004 pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme apartament me sip. 79.3 m² dhe të drejtat reale mbi të, bazuar në përcaktimet e germës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit, subjekti dhe personat e lidhur mbartin detyrimin të deklarojnë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to.

4.7. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë faktin se burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm nga privatizimi, është e regjistruar në regjistrat publikë, si dhe kjo pasaktësi në deklaratim nuk lidhet me fshehjen e kësaj pasurie duke e vendosur në emër të personave të tjerë, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore, sipas ligjit nr. 84/2016.

4.8. Në konkluzion, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi në deklaratim nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5. Automjeti tip “Ford Galaxy”, vit prodhimi 1998, vlera 250.000 lekë

5.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 bashkëshorti i subjektit deklaron se ka në pronësi automjetin tip “Ford Galaxy”, vit prodhimi 1998, i regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Transportit Tiranë, blerë në vitin 2007, me vlerë 250.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Si burim krijimi deklaron: “*Blerë në vitin 2007 me kursime familjare nga vëllai i bashkëshortes*”. Për vërtetimin e deklaratimeve të tij subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues²⁶.

5.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se – në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës së vitit 2014, subjekti deklaron automjet me targa ***, tip “Ford Galaxy”, vlera 100.000 lekë. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2016, lëshuar nga DPSHTRR-ja.

5.3. Referuar informacionit të përcjellë nga DRSHTRR-ja²⁷, rezulton se në emër të shtetasit A. B. figuron i regjistruar automjeti me targa ***, vit prodhimi 1998. Sipas dokumentacionit të përcjellë, ky automjet është blerë me anë të kontratës nr. ***, datë 22.6.2007, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A. D. dhe palës blerëse A. B., në shumën

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2016, lëshuar nga DPSHTRR-ja, leja e qarkullimit rrugor për automjetin tip “Ford Galaxy”, me targa ***, kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 22.6.2007, deklarata e zhdoganimit të automjetit datë 20.2.2007.

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2020.

250.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Sipas deklaratës doganore datë 20.2.2007, automjeti ka kushtuar 1.500 euro (kursi i këmbimit 124.63 lekë) dhe shpenzimet doganore 154.963 lekë, në total 341.908 lekë.

5.4. Rezulton se ky automjet është blerë nga subjekti rreth 91.908 lekë më lirë, vetëm 4 muaj më vonë. Komisioni vëren se ka mospërputhje në vlerën e deklaruar për blerjen e këtij automjeti, pasi në DIPP/2014 e deklaroi në shumën 100.000 lekë, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* dhe, sipas kontratës, rezulton të jetë blerë në shumën 250.000 lekë.

5.5. Me anë të pyetësorit nr. 1²⁸, subjektit iu kërkua të shpjegojë mospërputhjet në vlerën e deklaruar të çmimit të këtij automjeti, si dhe blerjen e tij vetëm 4 muaj më vonë në një vlerë rreth 91.908 lekë më të ulët krahasuar me vlerën e blerjes së shitësit A. D.. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të qartësojë nëse vëllai i saj ka qenë në cilësinë e dhuruesit të automjetit, duke qenë se në deklaratën *Vetting* janë deklaruar si burim i këtij automjeti kursimet familjare të vëllait. Në përgjigje²⁹, subjekti deklaroi se vlera 100.000 lekë, e deklaruar në DIPP/2014 është një lapsus i bërë gjatë plotësimit të kësaj deklarate nga bashkëshorti. Vlera e blerjes së automjetit është ajo që është deklaruar në deklaratën *Vetting* në shumën 250.000 lekë dhe në kontratë. Ky automjet ka qenë i vëllait A. D., i cili jeton prej vitit 1994 në Itali (rezident dhe shtetas italian). Kur vëllai ka ardhur për vizitë në Shqipëri, automjeti ka pësuar një defekt në paketën qendrore elektronike (centralino), defekt që bënte të pamundur ndezjen e automjetit. Për këtë arsye vëllai e ka lënë automjetin në Shqipëri dhe duke qenë se bashkëshorti i subjektit u mor me riparimin e këtij automjeti dhe nuk kishin një automjet të tyrin, e ka blerë dhe diferenca në çmim është pikërisht për këtë shkak.

5.6. Subjekti sqaron se në deklaratën *Vetting* të bashkëshortit, literalisht është shkruar: *“Një autoveturë Ford Galaxy, me vit prodhimi 1998, e regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Transportit Tiranë, blerë në vitin 2007 me kursime familjare nga vëllai i bashkëshortes”*. Pra, është deklaruar se automjeti është blerë me kursime familjare dhe, më tej, fjalja vazhdon nga vëllai i bashkëshortes. Ndoshta, ndërtimi i fjalisë nuk është i saktë (pas fjalës familjare duhet të ishte vendosur presje), vijon subjekti, por kuptimi dhe realiteti i këtij deklarimi të bashkëshortit është: *“Autovetura është blerë në vitin 2007, shitës është vëllai i bashkëshortes, burimi i krijimit janë kursimet tona familjare”*. Në përfundim, subjekti shpjegon se vëllai i saj është në cilësinë e shitësit dhe jo të dhuruesit, pra veprimi juridik është shitje dhe jo dhurim.

5.7. Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2005 – 22.6.2007, për të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

5.8. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar

²⁸E-mail datë 14.10.2022.

²⁹Dokumentacioni i protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.10.2022.

saktë në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

HETIME TË TJERA

6. Lidhur me adresat e banimit

6.1. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti deklaroi si adresë banimi: “*Rruga ****, Tiranë*”. Në DIPP/2004, deklaroi si adresë banimi: rruga “****”, vilë private me qira. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, në DIPP/2014 dhe në DIPP/2015, deklaroi si adresë: rruga “****”. Pallati i shoqërisë “****”, kati 3, Tiranë. Në deklaratën *Vetting* dhe DIPP/2016 ka deklaruar si adresë të gjendjes civile “*Tiranë, njësia ****, rruga *****” dhe si adresë banimi “*apartament me qira, rruga ****, nd. ****, h. ****, kati ****, ap. ****, Tiranë*”. Paguesa mujore e qirasë deri në tetor të vitit 2016 është 10.000 lekë, ndërsa për nëntor – dhjetor 2016 në vlerën 15.000 lekë.

6.2. Në pyetësorin standard deklaroi se nga periudha: (i) 16.2.1996 – 14.1.1999 ka banuar në shtëpinë e prindërve Lagjja Nr. ****, p. ****, kati ****, M., apartament i përfituar me privatizim nga familjaret e subjektit; (ii) janar 1999 – shtator 2001 ka banuar me qira në Tepelenë në lagjen “****”, ap. ****, kati ****, me pronare znj. E. E. P.. Qiraja i është paguar babait të pronares së objektit, pasi kjo e fundit ka qenë në Greqi. Nuk është bërë kontratë shkresore, ka qenë marrëveshje verbale mes bashkëshortit të subjektit A. B. dhe z. E. P. (babait të pronares). Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ****, datë 22.7.2020, sipas së cilës, deklaruesja E. P. deklaroi se shtetasi A. B. ka banuar në banesën e dhënë me qira nga ana e saj në periudhën janar 1999 – shtator 2001, ka paguar qira mujore në shumën 4.000 lekë, e cila i është paguar babait të saj. Bashkëshorti i subjektit deklaroi se ka banuar në këtë banesë në periudhën e sipërcituar. Më tej, subjekti ka paraqitur vërtetimin hipotekor datë 12.1.2016, sipas të cilit në emër të znj. E. P. është e regjistruar pasuria me nr. ****, z. k. ****, me sip. 60.1 m², me sip. truall 14 m², me emërtimin apartamenti nr. ****, shkalla ****, kati ****, lagjja “****”, Tepelenë dhe kjo pasuri është përfituar me kontratë privatizimi nr. ****, datë 7.9.1994; (iii) tetor 2001 – gusht 2006 ka banuar në Tiranë me qira në rrugën “****”, me pronar shtetasin L. Z. M., paguar qira vetë pronarit, nuk është bërë kontratë shkresore, por ka qenë marrëveshje verbale mes bashkëshortit të subjektit dhe pronarit. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ****, datë 17.7.2020, ku z. L. M. deklaroi se është pronar i një pasurie truall + ndërtesë, në rrugën “****”, Tiranë dhe nga periudha tetor 2001 – gusht 2006, z. A. B. ka banuar në këtë banesë me qira mujore në shumën 20.000 lekë. Më tej, subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë nr. ****, datë 30.10.2019, për pasurinë e regjistruar në emër të shtetasit L. M., me nr. ****, vol. ****, f. ****, në rrugën “****”, Tiranë, lloji i pasurisë “truall” me sip. 318 m², nga të cilat 106 m² ndërtesë. Nga kontrolli në sistemin multifunksional të ASHK-së, kjo pronë godinë banimi 3 kate figurojnë e regjistruar në emër të z. L. Z. M., sipas përshkrimit leja e legalizimit nr. ****, datë 14.12.2018; (iv) shtator 2006 – gusht 2009 ka banuar me qira në Tiranë, rruga “****”, kati ****, pallati 10-katësh i ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k. pronar i objektit G. H. J.. Qiraja i është paguar vetë pronarit, nuk është bërë kontratë shkresore, por ka qenë marrëveshje verbale mes bashkëshortit të subjektit dhe

pronarit. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.7.2020, ku shtetasi G. J. deklaroi se është pronar i pasurisë apartament në rrugën “****”, Tiranë dhe nga periudha gusht 2006 – shtator 2009, me qira 20.000 lekë/muaj. Të njëjtën gjë deklaroi edhe bashkëshorti i subjektit. Më tej ka paraqitur kontratën e shitjes nr. ***, datë 4.12.2007, ku vërtetohet që z. G. J. ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sip. 66.8 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë në rrugën “****” Tiranë, me çmim 22.712, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në seksionin “Detyrimet e palëve”, pika 5.3 specifikohet se blerësi e ka marrë në dorëzim pronën objekt shitejeje para redaktimit të kësaj kontrate, çka shpjegon faktin pse subjekti ka filluar të banojë rreth 3 muaj para se të lidhej kontrata e shitjes së këtij apartamenti; (v) shtator 2009 – aktualisht, deklaroi se banon me qira në rrugën “****”, nd. ***, h. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë (sipas adresarit të vendosur nga bashkia) ose rruga “****”, shk. ***, k. ***, ap. *** (sipas kontratës së qirasë dhe certifikatës së pronësisë). Qiraja i është paguar shtetasës M. Sh. (G.), motrës së pronarit, pasi ky i fundit jeton jashtë shtetit. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti kontratën e qirasë nr. ***, datë 1.9.2009, lidhur ndërmjet z. L. Sh., në cilësinë e qiradhënësit dhe z. A. B., në cilësinë e qiramarrësit, për dhënien më qira të apartamentit që ndodhet në rrugën “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, me sip. 102 m², pronësinë e të cilit e vërteton me certifikatën e pronësisë së lëshuar në datën 20.8.2007 bashkëlidhur kontratës. Çmimi i qirasë është 25.000 lekë/muaj. Në kontratë specifikohet që do t’i paguhet znj. M. Sh. (G.) çdo datë 1-3 të çdo muaji paradhënie.

6.3. Gjatë hetimit të Komisionit rezultoi se në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, në DIPP/2014 dhe në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile: *rruga “****”, pallati i shoqërisë “****”, kati 3, Tiranë*. Me anë të pyetësorit shtesë nr. 1, subjekti u pyet lidhur me sa deklaroi dhe nëse ka banuar ndonjëherë në këtë adresë. Në përgjigje, subjekti deklaroi kjo është adresa e banimit të prindërve të tij dhe se nuk ka banuar asnjëherë në këtë adresë. Arsyeja e vetme që është deklaruar është që komunikimet zyrtare/postare të ishin të sigurta për shkak të pasaktësive që ekzistojnë në sistemin e adresave. Më tej shpjegon se që nga martesa në vitin 1999 dhe aktualisht ka jetuar dhe vijon të jetojë në apartamente me qira. Aktualisht, nga muaji nëntor 2021, jeton me qira në një adresë tjetër: *rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, ***, Tiranë*³⁰.

6.4. Me anë të pyetësorit nr. 2³¹, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues që vërteton lidhjen e prindërve me këtë pasuri, si dhe të deklarojë nëse adresa e mësipërme është e njëjtë me adresën e gjendjes civile: “Njësia ***, rr. ‘****’”, e deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në përgjigje të pyetësorit³², subjekti, në cilësinë e provës, paraqiti kontratën e sipërmarrjes datë 16.1.2004, e lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., me cilësinë e sipërmarrësit, dhe shtetasve Y. dhe M. D., me cilësinë e porositësit, vërtetim noterial nr. *** rep., datë 16.1.2004, si dhe vendimin nr. ***, datë 30.9.2022, “Për legalizimin e ndërtimit pa leje në emër të shtetasve Y. dhe M. D.”. Subjekti sqaron se është e njëjta adresë

³⁰Subjekti ka dorëzuar në cilësinë e provës kontratën e qirasë nr. ***, datë 2.11.2021, certifikatë pronësie e apartamentit në emër të shtetasve F. dhe S. G., datë 10.9.2013.

³¹E-mail datë 25.10.2022, ora 13:16.

³²E-mail datë 28.10.2022, ora 12:38.

dhe se referuar dokumenteve të paraqitura ky apartament ka emërtime të ndryshme. Vendndodhja përshkruhet rruga “****”, ndërsa në vendimin e legalizimit si vendndodhje e kësaj pasurie është shënuar rruga “****”, ndërkohë që sipas adresarit të bashkisë është rruga “****”, fakt që provon problematikën e sistemit të adresave. Në përfundim, subjekti deklaroi se nuk ka asnjë lidhje pronësore me këtë pasuri, nuk ka jetuar/marrë në përdorim ndonjëherë këtë pasuri/apartament.

6.5. Nga hetimi i Komisionit³³ subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë të jenë banorë të regjistruar në Njësinë Administrative Nr. ***, rruga “****”, nd. ***, h. ***, Tiranë, konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

6.6. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se nuk u evidentuan problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

7. Detyrimet financiare

7.1. Referuar informacionit të përcjellë nga “OTP Bank”³⁴ (ish-banka “****”), në emër të subjektit dhe bashkëshortit A. B. rezultoi: (i) kredi me këste - standard, nr. ***, në vlerën 500.000 lekë, hapur në datën 4.6.2015 dhe maturimi më 4.6.2017; dhe (ii) kredi me këste - standard, nr. ***, në vlerën 800.000 lekë, hapur në datën 7.11.2016 dhe maturimi më 7.11.2019³⁵.

7.2. Lidhur me kredinë në vlerën 500.000 lekë – në DIPP/2015 subjekti ka deklaruar se kjo kredi është marrë me qëllim fillimin e aktivitetit privat të bashkëshortit, ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar nga “OTP Bank” (më parë banka “****”) rezultoi se kredia e marrë në datën 4.6.2015, me vlerë 500.000 lekë, do të përdoret për mobilimin e shtëpisë³⁶.

7.3. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë mospërputhje, i cili në përgjigje deklaroi se është e vërtetë se në kontratë është përcaktuar që kredia do të përdoret për mobilim dhe për këtë qëllim është marrë, por duke qenë se bashkëshorti A. B. kishte marrë ndërkohë një ambient me qira dhe kërkonte të hapte një aktivitet privat, ku të vetëpunësohej, nevojat imediate për fillimin e këtij aktiviteti kushtëzoi përdorimin e kredisë për këtë qëllim dhe jo për mobilim. Në cilësinë e provës subjekti paraqiti ekstraktin e personit fizik “A. B.”, datë 17.9.2015, dhe kontratën e qirasë nr. ***, datë 6.2.2015, të lidhur ndërmjet qiradhënësit G. Z. dhe qiramarrësit A. B., sipas së cilës është dhënë më qira njësi me sip. 42 m², e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me çmim 10.000 lekë/muaj, si dhe është lënë një garanci në vlerën 200.000 lekë.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 27.10.2022.

³⁴Shkresë e protokolluar në Komision nr. *** prot., datë 28.7.2020.

³⁵Deklaruar edhe në deklaratën Vetting nga subjekti: “Kredi bankare ekspres në lekë, marrë së bashku me bashkëshortin, në shumën 800.000 lekë në bankën ‘****’ sh.a., nr. Kontrate ***, me kohëzgjatje 36 muaj, nga 7.11.2016 deri 7.11.2019. Me interes: 7.5%. Vlera e këstit mujor: 24.881 lekë. Shlyer dy këste: 49.762 lekë. Shuma e detyrimit mbetur pa shlyer: 760.113 lekë”.

³⁶Shkresë nr. *** , datë 27.7.2020 (seksioni A i kontratës, pika nr. 2).

7.4. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë, Komisioni konstaton se subjekti ka tërhequr vlerën 415.000 lekë, konkretisht 400.000 lekë në datën 8.6.2015 dhe 15.000 lekë në datën 31.8.2015.

7.5. Më tej, subjekti ka paguar komisione, interesa dhe principal: vlerën 133.650 lekë në vitin 2015; dhe vlerën 399.252 lekë në vitin 2016. Shlyerja e parakohshme në vitin 2016 është bërë me anë të kredisë së re të marrë, konkretisht kredi ekspres nr. ***, vlerë 800.000 lekë.

7.6. Lidhur me kredinë me vlerë 800.000 lekë – në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar kredi bankare ekspres në lekë, marrë së bashku me bashkëshortin, në shumën 800.000 lekë, në bankën “****”, me nr. Kontrate ***, me kohëzgjatje 36 muaj, 7.11.2016 – 7.11.2019. Me interes: 7.5%. Vlera e këstit mujor: 24.881 lekë. Shlyer dy këste: 49.762 lekë. Shuma e detyrimit e mbetur pa shlyer: 760.113 lekë.

7.7. Në DIPP/2016, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar kredi konsumatore ekspres me vlerë 800.000 lekë. Referuar kontratës së kredisë³⁷, kredia do të përdoret për mobilim shtëpie.

7.8. Në pyetësonin standard lidhur me mobilimin e shtëpisë, subjekti ka deklaruar se nuk ka në pronësi apartament banimi dhe se pajisjet e shtëpisë janë blerë që në vitin e parë të martesës, 1999. Gjatë gjithë kësaj kohe janë rinovuar vetëm një herë kolltukët dhe televizori. Shpenzimet e bëra për këtë qëllim nuk e kanë kaluar asnjëherë vlerën për të cilën është pasur detyrimi për deklarim për periudhën që e ka pasur atë detyrim.

7.9. Në DIPP/2016, subjekti deklaroi se shpenzimet për mobilim, mjekime etj., në total vlera 447.296 lekë, janë kryer me një pjesë të parave të marra nga kredia nr. *** në bankën “****”.

7.10. Me anë të pyetësonit nr. 1 subjekti u pyet në lidhje me shpenzimet e mobilimit, i cili në përgjigje ka deklaruar se në vitin 1999 vlera e investimit ka qenë përafërsisht 50.000 lekë, ndërsa në vitin 2016 vlera e investimit ka qenë përafërsisht 100.000 lekë.

7.11. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë rezulton se pas lëvrimit të kësaj kredie është shlyer plotësisht kredia e mëparshme (vlera 152.704 lekë) dhe, më tej, subjekti ka tërhequr një shumë totale prej 601.500 lekësh. Në vitin 2016, për këtë kredi, subjekti ka shlyer vlerën 44.881 lekë (komisione dhe interesa principal).

7.12. Në përfundim, Komisioni paraqiti në analizën financiare shpenzimet e kryera me kredinë e marrë, konkretisht 415.000 lekë në vitin 2015 dhe 447.296 lekë në vitin 2016, si edhe pagesat e kryera për kreditë, konkretisht 133.650 lekë në vitin 2015 dhe 399.252 lekë plus 44.881 lekë në vitin 2016.

7.13. Po kështu, Komisioni paraqiti shpenzimin në vlerën 200.000 lekë të kryer nga subjekti në shkurt të vitit 2015 si garanci për qiranë, pasi kontrata e qirasë mban datën 6.2.2015, ndërkohë që kredia është tërhequr në qershor të vitit 2015 dhe aktiviteti është

³⁷Paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* (seksioni A i kontratës, pika nr. 3).

regjistruar në datën 16.9.2015. Për rrjedhojë, kredia me vlerë 500.000 lekë nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e garancisë prej 200.000 lekësh.

7.14. Sa rezulton, është evidentuar nga Komisioni në analizën financiare të vitit 2015, trajtuar në pikën 3.9 - 3.17 të këtij vendimi.

8. Aktiviteti tregtar i bashkëshortit të subjektit

8.1. Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat me NIPT ***, me fitim gjithsej për vitet 2015 - 2016 në vlerën totale 158.216 lekë, konkretisht për vitin 2015 të ardhurat deklarohen në shumën 40.440 lekë, për vitin 2016 në shumën 530.672 lekë. Në DIPP-të vjetore personi i lidhur ka deklaruar: (i) në DIPP/2015, të ardhurat nga aktiviteti privat në vlerën 40.440 lekë, ndërsa fitimi në vlerën 14.126 lekë, (ii) në DIPP/2016, të ardhurat nga aktiviteti privat në vlerën 530.672 lekë, fitimi në vlerën 144.000 lekë.

8.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit³⁸ rezulton se bashkëshorti i subjektit A. B. figuron i regjistruar si person fizik me NIPT ***. Aktualisht subjekti ka statusin “pezulluar”. Sipas ekstraktit tregtar, veprimtaria e ushtruar ka për objekt riparim kompjuterësh dhe shërbime interneti, data e regjistrimit 16.9.2015. Adresa e aktivitetit në Tiranë: rruga “****”, Njësia Nr. ***, pallati i shoqërisë ***, kati i parë.

8.3. Bashkia Tiranë³⁹ konfirmon se shtetasi A. B. është regjistruar me NIPT ***, aktivitet “shërbime të ndryshme”, në adresën: Njësia Bashkiake nr. ***, rruga “****”, ndërtesë private nr. ***, kati ***. Data e licencimit: 16.9.2015. Subjekti ka kaluar me status “pezulluar” nga data 31.5.2017. Deklaruar xhiro 0-2 milionë lekë në vit gjatë periudhës 2015 – 31.5.2017.

8.4. Referuar dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁴⁰, konkretisht deklaratave të tatim-fitimit të thjeshtuar, vërehet se për vitin 2015 rezultojnë të ardhura në vlerën 40.440 lekë, shpenzime 26.224 lekë, fitim *bruto* 14.216 lekë, tatim fiks 8.333 lekë dhe, për rrjedhojë, fitim *neto* në vlerën 5.883 lekë, ndërsa për vitin 2016 rezultojnë të ardhurat në vlerën 530.672 lekë, shpenzime 386.672 lekë, fitim *bruto* dhe *neto* në vlerën 144.000 lekë (tatimi është zero).

8.5. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar “pagesë mujore qiraje për njësinë ku ushtror aktivitetin privat 15.000 lekë”, si dhe ka paraqitur kontratën e qirasë nr. ***, datë 16.11.2016, të ambientit të marrë për qëllim aktiviteti, të lidhur ndërmjet qiradhënësit I. D. dhe qiramarrësit A. B., për njësinë me sip. 31 m², z. k. ***, e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me çmim 15.000 lekë/muaj, për periudhën 15.11.2016 - 15.11.2017⁴¹.

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2020.

³⁹Dosjen e ILDKPKI-së, shkresë nr.*** prot., datë 17.4.2018.

⁴⁰Shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2020.

⁴¹Afati kohor është 1 vit, me të drejtë ripërtëritjeje, 15.11.2016 – 15.11.2017. Çmimi i qirasë është 15.000 lekë/muaj dhe pas mbarimit të vitit të parë do të rritet me 10%. Qiraja do të paguhet *cash* në datën 1-5 të çdo muaji paradhënie. Bashkëlidhur Aneksi nr. 3 i kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 10.3.2009, nënshkruar ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe znj. I. I., të cilët kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 21.6.2003 dhe Aneksi nr. 2 të kontratës

8.6. Në DIPP/2016 personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shpenzime qiraje për njësinë ku ushtron aktivitetin me vlerë 10.000 lekë/muaj deri në tetor 2016 dhe 15.000 lekë/muaj për nëntor-dhjetor 2016.

8.7. Në përfundim, në analizën financiare u pasqyruan të ardhura në vlerën 5.883 lekë në vitin 2015 dhe në vlerën 144.000 lekë në vitin 2016, si edhe shpenzime në vlerën 130.000 lekë në vitin 2016.

9. Analiza financiare

9.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur për periudhën mars 1997 – 2016.

9.2. Analiza financiare paraqitet e përmbledhur në vijim dhe e detajuar në Aneks 01 – Analiza financiare e detajuar dhe Aneks 02 – Metodika e analizës financiare, anekse të cilat iu përcollën subjektit të rivlerësimit bashkëlidhur relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 1997 – 2016

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit
1.3.1997 – 31.12.2003	0	0	0	3,986,061	0	2,495,276	1,490,785	0
2004	0	126,851	0	1,024,461	0	521,592	376,018	0
1.1.2005 – 25.2.2014	250,000	500,000	-291,380	7,614,499	0	6,259,152	896,727	0
26.2.2014 - 31.12.2014	0	0	-132,240	923,499	0	881,959	173,780	0
2015	0	0	113,316	1,103,276	500,000	1,721,478	-231,518	-231,518
2016	0	-300,000	113,843	1,530,660	800,000	2,026,705	490,112	0
TOTAL	250,000	326,851	- 196,461	16,182,456	1,300,000	13,906,162	3,195,904	-231,518

9.3. Në përfundim, pas analizimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 231.518 lekë për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2015.

10. Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

10.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur për periudhën mars 1997 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 231.518 lekë për të kryer shpenzimet në vitin 2015.

10.2. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e pamjaftueshmërisë në shumën 231.518 lekë⁴², në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerësohet se subjekti ka arritur të

datë 9.12.2004, ku rezulton se znj. I. B. e ka përfutur këtë pronë si pronare e trullit mbi të cilin është ndërtuar pallati nga shoqëria “***” sh.p.k.

⁴²Sikundër u trajtua edhe në pikën 3 të këtij vendimi.

argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

10.3. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

10.4. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit E. B. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Edlira Bako ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Edlira Bako (Duraj).

4. Komisioni, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 15.9.2022, ka kërkuar përditësimin e raportit me materialet shtesë që mund të disponohen deri aktualisht. Sipas informacionit të vënë në dispozicion në datën 25.10.2022, rezulton se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin e rivlerësimit, çka nuk e ndryshon konstatimin e DSIK-së për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklarament të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit Edlira Bako ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” ka miratuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Edlira Bako.

3. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga të tria dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pesë materiale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

4. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularët e vetëdeklarimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit si prokurorë dhe më pas prokurorë e komanduar/drejtorë e inspektimit në gjykata e prokurori, është e specializuar në fushën e të drejtës penale, procedurat hetimore/gjyqësore penale dhe ligjet e tjera organike që lidhen me veprimtarinë e Prokurorisë. Detyrat e subjektit të rivlerësimit kanë konsistuar në drejtimin, organizimin, koordinimin e punës së stafit inspektues, përgatitjen e rekomandimeve lidhur me marrjen e masave për zgjidhjen e problemeve të konstatuara në gjykata e prokurori, studime që lidhen me organin e akuzës, si dhe pjesëmarrje në grupe pune brenda dhe jashtë institucionit për hartimin e projektligjeve etj.

5. Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Nga analiza e dokumenteve të vëzhguara konstatohet se subjekti Edlira Bako ka aftësi shumë të mira metodologjike, baza ligjore identifikohet lehtësisht në hartimin e raporteve, si dhe veprimet procedurale dokumentohen rregullisht dhe qartë ku në asnjë rast nuk ka mangësi në kryerjen e detyrave përkatëse. Në organizimin dhe planifikimin e punës subjekti ka përballuar volum të lartë ngarkese.

Arsyetimi ligjor

Nga analiza e dokumenteve ligjore të analizuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e detyrës zotëron dhe shpreh një nivel mjaft të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën, duke i përditësuar këto njohuri me ndryshimet në legjislacion dhe vendime të reja unifikuese.

6. Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti Edlira Bako, gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, është caktuar në Sektorin e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë pranë Ministrisë së Drejtësisë. Sipas të dhënave statistikore ka realizuar dhe trajtuar një numër të konsiderueshëm aktesh, më konkretisht: 3 raporte për inspektimet e kryera në prokurori paraqitur Kuvendit nga ministri i Drejtësisë; 3 rekomandime që ministri i Drejtësisë ia ka përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm; 16 inspektime të kryera në organin e akuzës, për të cilat janë realizuar edhe rekomandimet përkatëse; ankesa të trajtuara (prokurorinë) për vitin 2014 – 1226 praktika, vitin 2015 – 803 praktika dhe vitin 2016 – 1008 praktika; 49 inspektime të kryera në gjykata, për të cilat janë realizuar edhe rekomandimet përkatëse; ankesa të trajtuara (gjykatat) për vitin 2014 – 2253 praktika, vitin 2015 – 2316 praktika dhe vitin 2016 – 2813 praktika. Gjithashtu, është angazhuar në grupe pune për përgatitjen e projektligjeve të ndryshme dhe sidomos projektligjet ligjore të Reformës në Drejtësi.

7. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga ato të hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga aktet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga dokumentet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Edlira Bako. Nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa ndaj saj për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të paanësisë përgjatë përmbushjes së detyrës, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

8. Etika në punë

Aftësia për të bashkëpunuar

Në vlerësimet e punës subjekti Edlira Bako rezulton të jetë vlerësuar në nivelin “shumë mirë”. Gjithashtu, evidentohet se ka marrë përherë vlerësimet maksimale në punë përgjatë karrierës si prokurore dhe prokurore e komanduar.

9. Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh të organizuara pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

HETIMI I KOMISIONIT

10. Të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime – Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në

lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga viti 2006 e deri më sot. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 30.7.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit Edlira Bako (Duraj) nuk janë depozituar ankesa, nuk ka të dhëna për ndonjë kërkesë për procedim disiplinor të ministrit të Drejtësisë, si dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore ndaj subjektit.

11. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe verifikimi i informacioneve nga prokuroritë e rretheve gjyqësore rezultoi se nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal për përfshirje të drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.

12. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 15.9.2022, ka informuar se në emër të subjektit Edlira Bako nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

13. Mbi bazën e kërkesës për informacion Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., ka bërë me dije se për subjektin e rivlerësimit Edlira Bako, prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan, rezulton të jenë regjistruar dy kallëzime:

i) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 25.5.2021, ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** pas kallëzimit të bërë nga shtetasja E. G. Kallëzuesja ka kryer detyrën e gjyqtares së shkallës së parë dhe me vendimin nr.***, datë 5.7.2019, i është miratuar dorëheqja nga KLGJ-ja. Në maj të vitit 2021, kallëzuesja ka rënë në dijeni të faktit se në bazë të një kallëzimi penal prokurorja Edlira Bako kishte regjistruar një procedim penal ndaj saj dhe familjarëve, për të cilin realizonte hetime prej më shumë se një viti. Në pretendimin e kallëzueses, pavarësisht faktit se subjekti Edlira Bako e ka ditur prej fillimit se nuk ekzistonte asnjë shkak ligjor për fillimin e ndjekjes penale, duke përfituar nga funksioni e me qëllim denigrimin e figurës së gjyqtares E. G., ka regjistruar në mënyrë të kundërligjshme procedimin penal. Në këto rrethana, kallëzuesja ka pretenduar se nga ana e subjektit Edlira Bako janë konsumuar elementet e veprës penale “fillim i paligjshëm i ndjekjes penale”, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistroi kallëzimin penal nr. ***, viti 2021. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprime hetimore, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale për arsye se nëse palët në proces, si në rastin konkret kallëzuesja, vlerësojnë si të padrejtë veprimtarinë e prokurorit, ligji ka parashikuar mjete dhe forma, të cilat mund të përdoren brenda afateve procedurale për t’u ankuar në gjykatë. Gjykata është organi kompetent që vlerëson ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorit. Nga hetimi nuk rezultoi që subjekti, në cilësinë e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan të ketë kryer ndonjë veprim në mospërmbushje të rregullt të detyrës. Në këto rrethana, në datën 14.6.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, sipas nenit 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale.

ii) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 16.11.2021, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, pas kallëzimit të bërë nga shtetasja S. Xh., e cila pretendon se në vitin 2017 në rrethana të dyshimta, vëllai i saj, i cili vuante dënimin në IEVP-në Peqin, është gjetur i pajetë. Paraprakisht, organi i akuzës ka zhvilluar hetime në lidhje me veprën penale “shkaktim vetëvrasjeje”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal dhe më pas ka vendosur pushimin e procedimit. Vendimi i pushimit është ankimuar dhe gjykata ka vendosur që hetimet të vijojnë në drejtim të veprës penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, hetime të cilat deri në momentin kur shtetasja S. Xh. ka bërë kallëzim për subjektin vijonin. Kallëzuesja pretendon se subjekti Edlira Bako, në bashkëpunim me arkivisten e IEVP-së Peqin, kanë zhdukur provat me qëllim fshehjen e rrethanave reale të ngjarjes së ndodhur, duke konsumuar elementet e veprës penale “shpërdorim detyre” dhe “zhdukje e dokumenteve”.

Prokuroria e Rrethit Tiranë regjistroi kallëzimin penal nr. ***, viti 2021. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprime hetimore në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori argumenton se nga hetimi nuk rezultoi që subjekti Edlira Bako, në cilësinë e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan, të ketë kryer ndonjë veprim në mospërbushje të rregullt të detyrës. Në këto rrethana, në datën 26.11.2021, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, sipas nenit 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale.

14. Gjithashtu, rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit Edlira Bako nuk janë paraqitur denoncime nga publiku pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

15. Në përfundim, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Edlira Bako është *e aftë*, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçiente në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Edlira Bako ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, dhe referuar germës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Edlira Bako, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj